



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE URBANE ELBASAN

Elbasan, më 24 / 04 /2026

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS - “Blerje materiale elektrike”.

LLOJI PROÇEDURËS - “Procedurë e hapur e thjeshtuar-Marrëveshje kuader –mallra”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
31681410-0 materiale elektrike

VLERA E FONDIT LIMIT : 7,493,400 (shtatëmilionë e katërqind e nëntëdhjetë e tremijë e katërqind) **lekë pa t.v.sh.**

Bazuar në urdhërin e brendshëm “Për ngritjen e komisionit për testimin e tregut me qëllim përlllogaritjen e fondit limit”, komisioni i ngarkuar me anë të Formularëve të Posaçem ka testuar tregun si dhe ka përlllogaritur fondin limit për sasinë e mallit që kërkohet të porkurohet.

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontrator Agjencia e Shërbimeve Publike Urbane Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si mëposhte:

Shtojca 7

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohej për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përgjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohej për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfasuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 të miratuar nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formulari i Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 4;*
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

a.Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilin është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

- a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;**
- b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.**

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 9

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar në nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore **përgjatë tre viteve të fundit financiare**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e fondit limit të prokuruar**.

Kriteri 2.1 është vendosur referuar nenit 43 pika 1,2,3 dhe nenit 55 pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,si dhe bazuar ne Nenin 77 pika 3,e LPP nr.162,date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”.

2.2 Operatori ekonomik duhet te kete paguar **taksat dhe tarifat vendore për vitin 2025 (këstet e maturuara)** për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit.

Kriteri 2.2 eshte vendosur bazuar ne nenin 76, pika 2 te LPP si dhe ne ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

3. Kapaciteti teknik dhe profesional:

3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura

tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara,

ose

- b) Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,** si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe/ose të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kriteri 3.1 është vendosur referuar nenit 40 pika 4 dhe nenit 55, pika 4 germa b) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë :

- **Një automjet të përshtatshëm**, për transportin e mallit;

Për të cilat duhet të paraqesë dokumentet e mëposhtëm :

- **Aktin e pronësisë së mjetit përkatës**

Ose

- **Kontratën noteriale të marrjes me qera të mjetit**, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë që ka pronari, i cili e jep me qira.

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë (qoftë në pronësi apo me qera) duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit Teknik, siguracionin e mjetit, taksat vjetore si dhe lejen e transportit për ato mjete që pajisen me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.

Ky kriter do të përmbushet nga O.E. me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e automjetit, dorezohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kriteri 3.2 është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij **kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit Automjeti i përshtatshëm do të shërbejë për transportin mallit objekt prokurimi në magazinën e Autoritetit Kontraktor.**

3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me çertifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që ka lidhje me objektin e kontratës, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim, si më poshtë:

-SSH/ EN - ISO 9001:2015 në fushën e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente, e vlefshme dhe të përputhet me mallin objekt prokurimi;

-SSH/ EN - ISO 14001 : 2015 , në fushën e menaxhimit të mjedisit ose ekuivalente, e vlefshme dhe të përputhet me mallin objekt prokurimi;

-SSH/ EN - ISO 50001 :2015 në fushën menaxhimit të energjisë ose ekuivalente, e vlefshme dhe të përputhet me mallin objekt prokurimi;

Kriteri 3.3 është vendosur në përputhje me Nenin 40 pika 6 gërma (c) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, bazuar në nenin 44 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 si dhe bazuar në nenin 79 të LPP. **Ky kriter është vendosur që AK të ketë sigurinë që operatori ekonomik ofertues të jetë i pajisur me certifikatën e menaxhimit të cilësisë gjë e cila krijon bindjen dhe sigurinë të AK që ky OE do të ofertojë produkte të certifikuara të një cilësie të mirë, në përputhje me standartet ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga DPA.**

3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën **një punonjës Inxhinier Elektrik** të diplomuar në Inxhinieri Elektrike, të provuar përmes diplomës në këtë fushë, kontratës së punës dhe listëpagesave nga sigurimet shoqërore.

Ky kriter do të përmbushet nga O.E. me anë të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues : diploma; kontratë pune dhe listëpagesat e sigurimeve shoqërore, për vërtetimin e kualifikimit dhe punësimit të punonjësit, dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Kriteri 3.4 është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij **kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion burimet e nevojshme njerëzore të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit. Inxhinieri elektrik do të shërbejë për ndjekjen teknike të furnizimit, garantimin e përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike dhe verifikim të parametrave elektrikë.**

4.Kushte të tjera :

4.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë të paktën një mostër për elementët e mëposhtëm sipas preventivit dhe specifikimeve teknike të kërkuara në datën dhe orën e hapjes së tenderit në ambientet e Agjencisë së Sherbimeve Publike Urbane Elbasan, Lagje Visarion Xhuvani, Rruga e Re, si vijon :

Nr.	EMERTIMI	NJESIA	SASIA
1	Llambë 150 W E40	cope	1
2	Llambë 250 W HPS sodium	cope	1
3	Llambë LED 40 W me reduktor	cope	1
4	Llambë 250 W T=3800 K	cope	1
5	Llambë 250 W HQL me zhive	cope	1
6	Llambë LED 15 W E27	cope	1
7	Rele kohe (Timer)	cope	1
8	Fotoelement (rele muzgu)	cope	1
9	Lëshues 200 A	cope	1
10	Automat 40 A IP	cope	1
11	Automat 63 A 3P	cope	1
12	Automat 400 A 3P	cope	1
13	Kabëll bakri 3 x 2.5 mm ²	m	1
14	Kabëll bakri 4 x 4 mm ²	m	1
15	Kabëll bakri 4 x 6 mm ²	m	1
16	Kabëll ABC 4 x 16 mm ²	m	1

Mosparaqitja e mostrave në ditën dhe orën e caktuar, përbën kusht për skualifikim të OE ofertues në këtë procedure prokurimi.

Kriteri 4.1 është vendosur në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të paraqesin mostra të mallit që kërkohet të prokurohet, kur kjo kërkohet nga autoriteti

kontraktor si e rëndësishme për vlerësimin e ofertës. **Autoriteti ynë kontraktor kërkon paraqitjen e mostrave për mallrat të cilat janë të konsiderueshme në sasi dhe në vlerë për vlerën në total të përlogaritur të kontratës dhe thelbësore për ndriçimin e qytetit të Elbasanit.**

4.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim të prodhuesit/ distributorit për çdo artikull të kërkuar (sipas preventivit). Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit, si : telefon, fax, e-mail,website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në raste verifikimesh të mëtejshme. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit / distributorit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer e i noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastet e paraqitjes së autorizimeve nga një distributor, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet Prodhuesit dhe Distributorit të Autorizuar.

Kriteri 4.2 është vendosur bazuar në nenin 40, pika 6 germa b dhe pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe me anë të këtij kriteri **AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave objekt prokurimi të cilat kërkohen që të jenë prodhuar në përputhje me standardet dhe cilësitë e kërkuara në DST. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së Operatori Ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës.**

4.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Katalogë ose fragmente të katalogëve të prodhuesit** për listën e mallrave objekt prokurimi, në të cilën të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen, për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara dhe skedën teknike për mallrat sipas preventivit në të cilën duhet të paraqiten të dhëna të sakta të kodit të produktit dhe web i firmës furnizuese.

Kriteri 4.3 bazohet në Nenin 40 pika 6 , germa b dhe c dhe pika 8 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. **Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi domosdoshmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin gjatë përdorimit të tyre.**

4.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Deklaratë Konfomiteti CE** të produktit për të treguar se materialet elektrike janë prodhuar në përputhje me direktivat e Komunitetit European.

Kriteri 4.4 bazohet ne Nenin 40 pika 6 , germa b dhe c dhe pika 8 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe **është vendosur duke pasur parasysh natyrën specifike të mallrave objekt prokurimi, për ti dëshmuar autoritetit kontraktor se malli i ofruar plotëson kërkesat e përcaktuara në DST, në përputhje me standartet ndërkombëtare të Komunitetit European.**

4.5 Operatori ekonomik duhet të parqesë ofertën teknike për mallrat objekt prokurimi, në formën e një table sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze me të dhënat sim ë poshtë :

-Emri i kompanisë prodhuese ose distributorit të autorizuar nga prodhuesi, me mallrat e të cilit OE do të paraqitet në tender.

-Numri i faqes në Katalog të Firmës Prodhuese ku ndodhet artikulli.

-Numri (kodi)identifikues i artikullit të ofruar, i shënuar me një shenjë dalluese.

Nr.	Emri i kompanisë prodhuese / i distributorit të autorizuar	Emertimi i katalogut të prodhuesit	Nr. i faqes	Nr. Identifikues i artikullit
1				

Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korrespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët / skedat teknike të dorëzuara.

Kriteri 4.5 bazohet ne Nenin 40 pika 6 , germa b dhe c dhe pika 8 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe **është vendosur me qëllim krijimin e lehtësive për autoritetin kontraktor në identifikimin e përputhshmërisë së mallit të ofruar me të dhënat e artikujve të katalogëve / skedave teknike dorëzuar nga OE.**

4.6 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë deklaratë për garancinë e mallit **(1 (një) vit nga momenti i vendosjes në përdorim)** sipas specifikimeve teknike si dhe që mallrat janë të një marke origjinale dhe të reja.

Kriteri 4.6 është vendosur në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKMnr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri përcaktohet që autoriteti kontraktor përveç kërkesave të parashikuara në nenin 40, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet dhe **garancia për mallin objekt prokurimi konsiderohet nga A.K. ynë si i nevojshëm për ekzekutimin me sukses të kontratës.**

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJËSIA E PROKURIMIT

XHOANA KOÇI

ERIND OSMANI

BLERINA KOTORRI